

AKT THEMELIMI

I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “ MIAN Consulting“ sh.p.k

Ne Tirane, sot me date 02 Dhjetor 2022, ne cilesine e “ortakut themelues “:

Z.Andi Trungu, i dtl. 19.01.1992, lindur ne Elbasan, Shqiperi, dhe banues Shqiperi, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, me numer personal J20119084N.

I cili ne cilesine e “ortakut themelues “, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, hartoj kete akt themelimi per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “ MIAN Consulting “ shpk mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare “ te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

KREU I

Neni 1 Krijimi

Shoqeria “ MIAN Consulting “ shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”). **Emri tregtar i shoqerise “ MIAN Consulting ”**

Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “MIAN Consulting“ shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaku i shoqerise”, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3 Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne Lagja Partizani, Rr. Mustafa Skuqi, Pall.Ri, Ap.17, Elbasan, Shqiperi. Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Shoqerise.

Neni 4 Objekti i veprimtarise

Sherbime konsulence te bazuara ne analize tregu, analize risku,menaxhim i risqeve te informacionit, sherbime te kontrollit te menaxhimit. Sherbime te konsulences financiare. rekuperim i kompanive ne veshtiresi, investigim detyrimesh dhe te drejtash ne situata problemesh midis paleve, sherbime per transakcionel e blerjes dhe shitjes se kapitaleve, konsulence manaxheriale dhe organizative, rekrutim dhe trainim professional si dhe sherbime te lidhura me to. Shoqeria mund te kryeje te gjitha aktivitetet qe do te konsiderohen te nevojshme per permbushjen e objektit te saj; Shoqeria mund te kete pjesemarrje ne Shoqeri te tjera me objekt te ngjashem. Plani Biznesi, Plane Investimesh, perllogaritje gjobash per deme ne gjykate.

Neni 5
Kohezgjatja

Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 50,000 lek.

Kapitali i mesipër është nënshkruar dhe do të shlyhet sapo të hapen llogaritë bankare të shoqërisë teresisht në të holla nga “ortaku i shoqërisë” i shoqërisë :

Z. Andi Trungu është zoterues i 1 kuote me vlerë 50,000 Lek, e cila përfaqëson 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundëjt të treteve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nepermjet emerimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Ortakut të shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga Administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 8
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakut është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim i statutit duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Ortakut, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e Administratoriëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratoriët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratoriëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Administratori i shoqërisë është: **Z. Andi Trungu**.

Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejta ripërteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Asambleja e Ortakut të shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe një person i tjetër jashtë ortakerisë.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe të jashtëzakonshem të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakut;

- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asambleja e Ortakut për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Asambleja e Ortakut edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara, Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të gjitha niveleve, zyrave të tatimit taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Përgjegjësia

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakut që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen Administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, Administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrës së tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt

e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administratori, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asambleja e Ortakut, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asambleja e Ortakut vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise “MIAN CONSULTING” shpk, u redaktua me vullnetin te lire e te plote te “ortakeve themelues”, ne 2 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe.

ORTAKET E SHOQERISE

Andi Trungu

